



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 85, datë 30.05.2016

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “CREDINS INVEST SH.A. - SHOQËRI
ADMINISTRUESE E FONDIT TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 4 dhe 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 20, pika 2 të Ligjit nr. 10197 “Për fondet e pensionit vullnetar”, të nenit 13, pika 3 dhe nenit 16, të Ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

“Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED” sh.a., e cila mban licencën nr. 3, datë 23.11.2011, për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, ka paraqitur kërkesën për shtrirjen e veprimtarisë edhe në administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Shtrirja e veprimtarisë reflektohet në ndryshimet e Statutit të Shoqërisë “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SiCRED” sh.a., si edhe në ndryshimin e emrit nga “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SiCRED” sh.a. në “CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”.

Në bazë të nenit 20, pika 2, të Ligjit nr. 10197 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Autoriteti mund të lejojë që shoqëria administruese e fondeve të pensionit, të kryejë veprimtari administrimi të fondeve të investimeve, me kusht që shoqëria administruese të jetë e pajisur me licencën e duhur, për të kryer këtë veprimtari.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Shoqërisë “CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive krahas veprimtarisë si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar.
2. Miratimin e ndryshimeve të statutit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit “SiCRED” sh.a., sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI